



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

Nr. 3457 prot.

Sarandë, më 20.05.2025

URDHËR

Nr. 87 Datë 20.05.2025

**“PËR DISIPLINIMIN E ORAREVE TË QARKULLIMIT TË MJETEVE MOTORIKE
DHE FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NGA SUBJEKTET
TREGTARE GJATË SEZONIT TURISTIK ”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja a , neni 64 të ligjit nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar neni 8, Udhëzimin e përbashkët nr.2 datë 15.11.2023 të Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale dhe Ministrisë së Brendshme ,

URDHËROJ:

1. Veprimtaria e mjeteve të rënda të ndërtimit si çekiç, fadroma, betoniera etj të ndërpritet për periudhën 15 Qershor – 30 Shtator , ndërsa për periudhën 1 tetor – 31 maj të vitit pasardhës do të punojnë në intervalet kohore 08⁰⁰ - 14⁰⁰ dhe 17⁰⁰ - 20⁰⁰.
2. Oraret e furnizimit të subjekteve tregëtare dhe njërive të tjera të shërbimit për periudhën 1 Qershor – 30 Shtator do të jenë:
 - Me automjete mbi 3,5 ton nga ora 24⁰⁰ - 09⁰⁰
 - Me automjete deri në 3,5 ton nga ora 24⁰⁰ - 09⁰⁰ dhe 13⁰⁰ - 17⁰⁰
3. Oraret e lejuara për zhvillimin e aktivitetit nga njësitë e shërbimit të parashikuara në aneksin 2 të Udhëzimit e përbashkët nr.2 datë 15.11.2023 të Ministrisë së Turizmit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale dhe Ministrisë së Brendshme , do të jetë si më poshtë:
 - a. Për periudhën tetor – maj
 - 08⁰⁰ - 14⁰⁰
 - 17⁰⁰ - 20⁰⁰
 - b. Për periudhën qershor - shtator
 - 08⁰⁰ - 14⁰⁰
 - 17⁰⁰ - 21⁰⁰
4. Përfundim nga parashikimet e pikës 2 të këtij urdhri , do të jenë:
 - Rastet e mjeteve të cilat kryejnë furnizimin e njërive tregëtare dhe të shërbimit me produktet ushqimore të ngrira
 - Rastet e mjeteve të cilat kryejnë veprimtari për realizimin e punimeve në shërbim të investimeve publike të Bashkisë Sarandë
 - Rastet e mjeteve të cilat qarkullimi i tyre paraqitet i nevojshëm dhe kërkohet për një afat kohor të përcaktuar

Në të gjitha rastet e mësipërme mjetet duhet të jenë pajisur me autorizimin përkatës lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të cilët do të jenë të detyruar të respektojnë kushte e vendosura në të.

5. Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit me detyrat si më poshtë:
 - të kontrollojnë zbatimin e orareve të përcaktuara më lartë duke kërkuar edhe sipas rasteve mbështetjen e Policisë së Shtetit
 - të lajmërojë subjektet ndërtuese për oraret e punës së mjeteve të rënda të përcaktuara në këtë urdhër dhe të kontrollojë zbatimin e orareve
 - të kryej ndalimin e menjëhershëm të veprimtarive të cilat prishin pushimin dhe qetësinë e qytetarëve
6. Ky urdhër hyn në fuqi pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë sipas nenit 8 pika a të Ligjit 107/2016 “ Për Prefektin e Qarkut” .
7. Për zbatimin e këtij urdhri , ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike , Policia Bashkiake dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

KRYETAR

Oltion ÇACI

